“Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, ajo vlen sa një e treta e Kuranit.”

Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se një burrë dëgjoi një person duke e përsëritur disa herë leximin e sures Ihlas (në namaz). Në mëngjes, vajti tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe i tregoi, duke aluduar në shkurtësinë e saj. I Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, ajo vlen sa një e treta e Kuranit.”
[Sahih] [Transmeton Buhariu]

Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përmendi se një njeri dëgjoi një tjetër duke e lexuar suren Ihlas vazhdimisht gjatë gjithë natës, pa shtuar asgjë tjetër. Të nesërmen, ai shkoi tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe ia përmendi këtë. Pyetësi, sikur e konsideronte se nuk ishte mjaftueshëm. Atëherë, Profeti ﷺ u betua për të konfirmuar: “Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, ajo vlen sa një e treta e Kuranit.”

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/65261